




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: Max Media Sh.p.k.
Emri Tregtar: Max Media
Numri Unik Identifikues: 812074425
Kandidati: Max Radio
Pronari: Edon Abdullahu
Adrsa: Dardania, Blloku 7/4, Nr.13, Prishtinë



VENDIM

mbi refuzimin e kërkesës të kandidatit Max Radio për licencë të radios në gjuhën turke për Komunën e Prizrenit

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Në bazë të Ligjit nr. 04/L-44 (Ligji për KPM), neni 3, paragrafi 2.1. të, KPM licencon transmetuesit publik e privat dhe i ripërtërin licencat, duke iu dhënë subjekteve të autorizuara të drejtën e përdorimit të frekuencave në Spektrin e Frekuencave të Transmetimit si dhe licencon të gjitha shërbimet mediale audiovizuale.
3. Neni 3, paragrafi 2.6. i ligjit për KPM, i jep kompetencë dhe e obligon KPM-në që të nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat shërbejnë për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
4. KPM, me datën 17 korrik 2023, ka marr vendim për shpalljen e konkursin publik për dhënien e një licence për shërbim medial audio (radio) me transmetim tokësorë në gjuhën turke, me mbulim regjional, për Komunën e Prizrenit. Konkursi është publikuar më datën 1 gusht 2023 dhe ka qenë i hapur për dorëzimin e aplikacioneve deri më datën 1 shtator 2023, ora 16:00.
5. Konkursi publik është zhvilluar mbi bazën e akteve nënligjore të KPM-së, të nevojshme për plotësimin dhe parashtrimin e aplikimit për licencë të KPM-së që janë 1. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2021/01); 2. Rregullorja për vlerësimin e aplikacioneve (KPM-2014/02) dhe 3. Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë (KPM-2017/06).
6. Kandidati "Max Radio" ka dorëzuar aplikacionin për licencë të radios në gjuhën turke me datën 31 gusht 2023.

Arsyetim

7. Komisioni konstaton se vendimi i KPM-së për dhënien e licencave të reja është bërë mbi bazën e nevojave të publikut dhe kapaciteteve të lira frekuencore në Komunën e Prizrenit, ku është vlerësuar se ka mungesë të shërbimeve mediale të radios në gjuhën turke.

1/2


8. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit për KPM, thekson se: *“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
9. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të pranuar përmes konkursit publik, bazuar në nenin 4, paragrafi 7, të Rregullores KPM-2014/02, me datën 13 shtator 2023, ka marr vendim për formimin e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve.
10. Komisioni Vlerësues i Aplikacioneve në takimin e tij të datës 26 shtator 2023, ka vlerësuar aplikacionin e kandidatit “Max Radio” dhe në bazë të këtij vlerësimi është konstatuar se ka mungesë të këtyre dokumenteve: dëshmia e përvojës së punës për personin përgjegjës për çështje programore, dëshmia e përvojës së punës për personin përgjegjës për çështje të ligjorë, mungon diploma përkatëse dhe dëshmia e përvojës së punës për personi përgjegjës për çështje teknike.
11. Gjithashtu, Komisioni Vlerësues i Aplikacioneve ka konstatuar se sipas skemës programore Max Radio ka deklaruar vetëm një program në gjuhën turke në kohëzgjatje prej 2 orëve si dhe një pjesë të programit muzikë në gjuhën turke, kurse pjesa tjetër e programit është në gjuhë tjera, ndërsa gjuha e transmetimit sipas konkursit është gjuha turke.
12. Komisioni konstaton se Komisioni Vlerësues i Aplikacioneve ka vlerësuar se kandidatit “Max Radio” nuk i ka plotësuar kushtet dhe kriteret sipas Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së për tu pajisur me licencë për shkak të mungesave në dokumentacion.

Vendim

13. Komisioni merr vendim për refuzimin e kërkesës së kandidatit “Max Radio” për licencë të radios në gjuhën turke, për Komunën e Prizrenit, për arsye të mungesave të dokumentacionit në aplikacionin për licencë të radios, të cekura më lartë në këtë vendim.

E drejta për ankesë

14. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafin 5 të Ligjit të KPM. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me paragrafin 2. të nenit 42 të këtij ligji.
15. Bordi për Ankesa do t’i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
16. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



13.10.2023
Data